



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Prosvete,
Nauke, Tehnologije i Inovacija - Ministry of Education, Science, Technology and
Innovation*

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA/KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE	
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SEKTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org. Jedinica	Broj Prot: 2531
Org Unit	Prot. No:
Nr. i faqeve	Data: 27.08.24
Br. stranica	Datum: 27.08.24
No. pages	Date
	Prishtine

Nr. 2-2531
Dt. 27-08-2024

Në bazë të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), Ligjit nr. 08/1-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, cit. 17 dhjetor 2021, si dhe nenit 32 të Rregullores (QRK) - nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nxjerr:

UDHËZUES PËR ZËVENDËSIMIN DHE PAGESËN E MËSIMDHËNËSVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE

Neni 1

Qëllimi i udhëzuesit

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) për marrjen e vendimit për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore nga buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit.

Neni 2

Vlerësimi i aftësisë për punë i mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore

1. Vlerësimin e aftësisë për punë të mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore dhe shkallën e sëmundjes e bëjnë institucionet shëndetësore publike (ISHP) përmes raporteve mjekësore.
2. Raportet mjekësore nga institucionet shëndetësore publike, dorëzohen në Drejtoritë e institucioneve edukativo- arsimore (IEA).

3. Drejtorët e IEA, raportet e pranuar nga ISHP, i dorëzojnë në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA).
4. DKA në bashkëpunim me drejtorin e IEA, i shqyrtojnë dhe verifikojnë raportet e ISHP dhe pajtohen për zëvendësimin dhe pagesën e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore.
5. Vendimin për zëvendësim dhe pagesë të mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore, e nxjerr drejtori i DKA-së.
6. Zëvendësimi i mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore bëhet pas shfrytëzimit të pushimit të lejuar mjekësor.
7. Zëvendësimi i mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore bëhet deri në fund të një gjysmëvjetori.
8. Zëvendësimi mund të ndërpritet në rast të përmirësimit të gjendjes shëndetësore të mësimdhënësve, bazuar në dëshmitë mjekësore nga ISHP.

Neni 3 Mënyra e zëvendësimit

1. Zëvendësimin e mësimdhënësve me gjendje të rëndë shëndetësore e bëjnë DKA-të.
2. Zëvendësimi bëhet me mësimdhënës të drejtimit përkatës duke:
 - 2.1 Angazhuar mësimdhënës të punësuar në komunë që nuk e kanë normën e plotë;
 - 2.2. Angazhuar mësimdhënës të punësuar në komunë që mund të marrin orë shtesë/mbinormë;
 - 2.3. Angazhuar mësimdhënës të rinj nga lista e pritjes;
 - 2.4. Shpallur konkurs.

Neni 4 Forma e pagesës

1. Mbështetur në dëshmitë mjekësore dhe vendimin e DKA-së, mësimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore, paguhen 100% të pagës bazë (baza e kontratës që ka të lidhur me institucionin përkatës).
2. Në pagë përfshihet edhe shtesa për përvojën e punës, kurse shtesa e kualifikimit nuk përfshihet.

Me datë: 26.08.2024

Fadile Dyla



Sekretare e përgjithshme MASHTI